



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljevoj / Predato Received / Delivery	02.03.2023	702	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SPONSHAK	2247/2023		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.501/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1970/2021, të datës 27.01.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.735/2021, të datës 04.06.2021 e parashtruar nga ankuesja me adresë rruga

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 02.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.501/2021 e datës 04.06.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës sipas kontratës së datës 11.05.2010 me numër të referencës 07/1-01A/0096, në pozitën "Përkthyes shqip-serbisht dhe anasjalltas" në Sektorin e përkthimeve-Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, siç rezulton nga shkresat e lëndës me datën 26.07.2021 ka parashtruar kërkesë tek Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës lidhur me kompensimin për pagën e 13-të (për vitin 2018, 2019 dhe 2020), shujtat ditore për vitet 2018, 2019,2020 dhe 2021, shtesën në pagë për kualifikimin shkollor si dhe shtesën në pagë për 0.5% të pagës për çdo vit dhe atë retroaktiv nga viti 2018 e tutje konform Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Drejtoria e personelit të Policisë së Kosovës me datën 27.07.2021, ka njoftuar ankuesen se është refuzuar kërkesa lidhur me

kompensimin e lartcekur për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore nga ana e Policisë së Kosovës.

Ankuesja me datën 04.06.2021, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin shujtës ditore, pagës së 13-të si dhe shtesën mbi pagën vjetore, nga viti 2018 deri 2020, respektivisht nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 09.06.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Me datën 21.06.2021, Policia e Kosovës përmes Departamentit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin me provat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje me datë 19.07.2021 ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtën që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative. Ankuesja ka ndjekur procedurat gjyqësore duke hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 27.01.2023 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1970/2021, i cili në Këshill është pranuar me datën 08.02.2023, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke e anuluar njoftimin e datës 19.07.2021 të KPSHMCK-së dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankueses me numër A.nr.501/2021 të datës 04.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 04.06.2021, e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 16.04.2021; Vërtetimin për punësim të ankueses me numër 07/1-01SAP-P/4619 të datës 27.05.2021; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër 07/1-01A/0096 të datës 11.05.2010 për ankuesen; Formularët për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen të datave 03.02.2021, 23.12.2021 dhe 22.01.2018; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.06.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 21.06.2021 nga ana e Drejtorisë së personelit të Policisë së Kosovës për ankuesen; Kërkesën e ankueses të datës 26.07.2021 e parashtruar përmes e-mailit zyrtar tek organi i punësimit; Përgjigjen në kërkesë të datës 27.07.2021 nga Njësia e Personelit të Policisë së Kosovës; Formularin PDP të datës 04.09.2015 lidhur me përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; E-mailat zyrtar të datës 22.04.2022, 20.04.2021, 20.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa lejuar, sepse:**

Bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Kolegji i këshillit konstaton se ankuesja fillimisht ka parashtruar ankesë me datën 04.06.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e shujtës ditore, pagës

së 13-të si dhe shtesën mbi pagën vjetore, nga viti 2018 deri 2020, respektivisht nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ndërsa me datën 26.07.2021 ka parashtruar kërkesën përmes e-mailit zyrtar për tek organi i punësimit konkretisht Policia e Kosovës lidhur me kompensimin e shujtës ditore, pagës shtesë vjetore si dhe pagën e trembëdhjetë për vitet 2018, 2019 dhe 2020 sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, e që përgjigjen e njëjta ka marrë nga kjo e fundit me datën 27.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se ankuesja lidhur me kompensimin në fjalë, nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje në kuadër të organit të punësimit, mirëpo e njëjta fillimisht me datën 04.06.2021 ka parashtruar ankesën në Këshill, ndërsa me datën 26.07.2021 ka parashtruar kërkesën përmes e-mailit zyrtar lidhur me këtë kompensim, e që tek me datën 27.07.2021 përmes shkresës zyrtare me numër 07/1-01SAP-P/6159 organi i punësimit ka marrë përgjigjen lidhur me kërkesën e saj ku e njëjta i 'u është refuzuar. Andaj lidhur me këtë objekt të ankesës nuk kemi veprim apo mosveprim nga kjo e fundit (organi i punësimit) para se ankuesja të ketë parashtruar ankesën në Këshill në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesja mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, kështu që në këtë kontekst bazuar në dispozitat e potencuara si më lartw ankesa e ankuseses është e palejuar.*

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.501/2021, datë 02.03.2023.

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuseses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHC- së.

